



# KOLEGJI ILIRIA

Licensuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Rruga Gazmend Zajmi Nr. 75 Prishtinë, Tel: +381 (0) 38 233 951 E-mail: info@uiliria.org Web: www.uiliria.org

*Në bazë të nenit 19 paragrafi 18, 19 dhe 20 të Statutit të Kolegjit ILIRIA të vitit 2018,  
Rektorati pranë Kolegjit, me datë 26/09/2019 mori këtë;*

## V E N D I M PËR ORGANIZIMIN E LIGJËRATAVE DHE USHTRIMEVE NË VITIN AKADEMIK 2019/2020

- I. Aprovohet fillimi i procesit mësimor, përkatësisht fillimi dhe kohëzgjatja e ligjëratave dhe ushtrimeve gjatë vitit akademik 2019/2020 për studentët e regjistruar pranë Kolegjit ILIRIA.
- II. Konstatohet se ligjëratat dhe ushtrimet në këtë vit akademik sipas Statutit do të organizohen në dy semestra atë dimëror dhe veror.
- III. Ligjëratat në semestrin dimëror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2019/2020 të fillojnë më 04 nëntor 2019 dhe të përfundojnë më 17 shkurt 2020.
- IV. Nga data 18 shkurt 2020, në periudhë gati një mujore deri në datë 15 mars 2020 është periudha e pushimit semestral.
- V. Ligjëratat në semestrin veror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2019/2020 të fillojnë më 16 mars 2020 dhe të përfundojnë më 30 qershor 2020
- VI. Urdhërohen njësitë akademike sipas kërkesës dhe nevojës së studentëve dhe të dekanatit të njërive akademike të organizohen edhe ligjëratat dhe ushtrime intenzive shtesë jashtë programit zyrtar të paraparë në bazë të rëndësisë në këto periudha: a) Një javë para afatit të provimeve; b) Dy javët e para të shtatorit c) Në kohëzgjatje prej dy javësh pas përfundimit të semestrit dimëror; d) Dy javë gjatë muajit Korrik.

## A r s y e t i m

Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA, ligjëratat për një semestër zgjasin 15 javë (3.5 muaj). Kolegji ILIRIA u ofron ligjëratat dhe ushtrime shtesë pa pagesë, sipas kërkesës së studentëve apo konstatimit nga dekanati i njësisë akademike.  
Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA viti akademik fillon me 01 Tetor dhe përfundon me 30 Shtator. Koha e fillimit të ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të organizohet brenda këtij intervali kohor, por jo domosdoshmërisht të përputhet me kohën e fillimit të vitit akademik.

Rektori